# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-441704**

VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nga kolltuqet e krevatet te mobiljet e vjetra në rrugë, Bashkia e Tiranës vijon aksionin e pastrimit: Mos i hidhni në hapësirat publike - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/nga-kolltuqet-e-krevatet-te-mobiljet-e-vjetra-ne-rruge-bashkia-e-tiranes-vijon-aksionin-e-pastrimit-mos-i-hidhni-ne-hapesirat-publike` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 20:28:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 08:55:09 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `392d0b6eff887a153661ab109995c0128fd6a90d06d5a4f47ec41498a1ae7c6c` |
| TEKSTI | `7ae1e2bd148a861a03906d9de2d003c74b99c0658b3147029f3489666887fd68` |
| PAMJA | `2e2c082f2418b44e205d0cd4f2dbb32c86a18f7d9a881516d48af0d9197d8962` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0e6f42336a7d3bdc8f164981ffb3f19660095a4fb61533d67bea5bb9acd01465` |
| E MËPARSHMJA | `7b9e68968e69a3860d5f39dd6e5f9ccc138c8e01344c017d488bcc487e281f8d` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0e6f42336a7d3bdc8f164981ffb3f19660095a4fb61533d67bea5bb9acd01465`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1

70 mijë të huaj vizitojnë Beratin, 10% më shumë se në vitin 2025! Historia dhe mikpritja vijojnë të tërheqin turistët: Një nga vendet më të bukura në Europë!

Sociale

# Nga kolltuqet e krevatet te mobiljet e vjetra në rrugë, Bashkia e Tiranës vijon aksionin e pastrimit: Mos i hidhni në hapësirat publike

*Bashkia bën me dije se gjatë javës strukturat e pastrimit kanë ndërhyrë në 11 njësitë administrative duke kryer pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, rrugicave, këndeve të lojërave dhe lulishteve.*


*Foto nga aksioni për pastrimin e Tiranës*

Redaksia
8 Shtator, 10:53 | **Përditesimi: 8 Shtator, 10:55**

Share Tweet




Bashkia e Tiranës thotë se po vijon aksionin e gjerë të pastrimit në të gjithë kryeqytetin, me ndërhyrje të përditshme në rrugë, lulishte, kënde lojërash, sipërfaqe të gjelbra dhe zona të banuara.

Sipas Bashkisë, një nga problematikat me të cilat përballen ekipet në terren është hedhja e mobiljeve, kolltuqeve, krevateve, pajisjeve të vjetra dhe mbetjeve të tjera voluminoze pranë koshave apo në hapësira publike.

Në kuadër të aksionit, mjetet e Bashkisë po punojnë për grumbullimin dhe evadimin e këtyre mbetjeve, ndërsa qytetarëve u kërkohet të mos i depozitojnë ato në rrugë. Për largimin e mbetjeve voluminoze mund të kontaktohet kompania publike Eco Tirana, në numrin 04 433 0250, ekipet e së cilës kryejnë tërheqjen e tyre.



LEXO EDHE:
**FBI 'zbarkon' nesër në Tiranë, 235 pjesëmarrës të agjencive ligjzbatuese nga Europa dhe SHBA mblidhen në kryeqytetin e Shqipërisë**

Bashkia bën me dije se gjatë javës strukturat e pastrimit kanë ndërhyrë në 11 njësitë administrative urbane, si dhe në lagjet nr. 12, 13 dhe 14, duke kryer pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, rrugicave, këndeve të lojërave dhe lulishteve.

Aksioni ka përfshirë gjithashtu pastrimin e partereve të gjelbra, mbledhjen e barit dhe mirëmbajtjen e urave përgjatë lumit Lana, si dhe sipërfaqet e gjelbra në Bulevardin e Ri dhe Bulevardin "Zogu I".

Sipas njoftimit, ekipet kanë vijuar punën edhe në blloqet e banimit, tregjet publike, trafikndarëset dhe lulishtet kryesore të qytetit, ndërsa ndërhyrje të posaçme janë zhvilluar në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe në Sheshin "Nënë Tereza".

Bashkia e Tiranës njofton se aksioni do të vijojë me fokus në pikat problematike dhe në largimin e mbetjeve të hedhura në mënyrë të parregullt në hapësirat publike.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Tirane | bashkia e tiranes | ndotje

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★ 4.1 / 5 (14 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente** Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18

**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



**Tiranë/ Qiratë e larta 'detyrojnë' studentët t'u drejtohen konvikteve, rriten me 70% kërkesat për akomodim**



Joana Preja

20 Shtator, 16:44



**Zjarr masiv në vendgrumbullimin e mbeturinave në Fushë-Krujë, tymi përhapet drejt Kamzës e Mamurrasit (VIDEO)**

20 Shtator, 16:11



**Bizneset e merrnin në punë, ajo vidhte xhiron e ditës dhe zhdukej! Arrestohet në Tiranë Kumrie Zika, policia: Janë dokumentuar 5 raste (VIDEO)**

20 Shtator, 14:13



**'Për sezonin tjetër, puna fillon tani', Demo vlerëson zjarrfikësit e Tiranës: Më shumë masa për parandalimin e zjarreve**

20 Shtator, 13:57



**Verdikti i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interpelancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjykimit?**

20 Shtator, 13:40




**"Erdhi gjyshi dhe e goditi me thikë" nipi 14-vjeçar tregon minutat e fundit të Lumturie Patushit para se të vritej nga bashkëshorti në Tiranë**

20 Shtator, 13:23



**Komiteti i Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri mblidhet në 21 dhe 22 shtator**

19 Shtator, 19:04



**Vdekja e bashkëshortes së ish-portierit Alban Hoxha, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e dy mjekëve! Dënimi për mjekim të pakujdesshëm**



Sokol Dema

19 Shtator, 16:12



**Vrau me thikë bashkëshorten, zbardhet dëshmia e autorit: Kishim konflikte! Qëndronte te shtëpia e vajzës, i kërkoja të vinte në banesën tonë**

19 Shtator, 15:59



U vra me thikë nga bashkëshorti në Tiranë, Report Tv siguron foton e viktimës 58-vjeçare

19 Shtator, 15:24



26 efektivë të FA nisin kurs 3 mujor, të mësosh gjuhën e ushtrisë në anglisht

19 Shtator, 15:15



Viti shkollor shton trafikun në Tiranë, PL: Bashkia të bëjë plan afatgjatë për menaxhimin e fluksit (VIDEO)

19 Shtator, 15:07



[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.